



MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR



AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS

RAPORT



Emetimi i gazrave serrë në Kosovë 2008-2013

Prishtinë, Nëntor 2015

Parathënie

Ndryshimet klimatike paraqesin një nga sfidat kryesore globale të njerëzimit. Derisa klima globale ka qenë shumë stabile gjatë 10 000 viteve të kaluara, duke siguruar një mundësi për zhvillimin e qytetërimit njerëzor, tani gjithnjë e më shumë ka shenja të dukshme se klima po ndryshon. Emetimet e gazrave serrë si rezultat i aktiviteteve të njeriut, janë një nga shkaktarët kryesorë të këtyre ndryshimeve.

Me qëllim të zbutjes dhe adaptimit ndaj këtyre ndryshimeve, në nivelin global deri me tani janë ndërmarrë veprime dhe janë arritur disa marrëveshje globale. Në vazhden e këtyre janë edhe Deklarata e Rios (1992) me obligimet për zbatimin e konceptit për zhvillimin e qëndrueshëm dhe Konventa për Ndryshimet Klimatike me obligimet për zvogëlimin e emetimeve të gazrave me efektin serës. Edhe Protokoli i Kyotos paraqet një hap shumë të rëndësishëm për kufizimin e emisioneve nga gazrat e serës.

Përpjekjet për të parandaluar ndryshimet klimatike dhe për të reduktuar emetimet e gazrave serrë, vazhdojnë edhe sot. Një nga këto përpjekje konsiderohet edhe Konferenca e Parisit për Klimën e njohur ndryshe si COP 21. Qëllimi i Konferencës është arritja e një marrëveshje, në të cilën të gjitha vendet do të marrin përsipër detyrimin që të reduktojnë emetimet e gazrave me efektin serë. Kjo marrëveshje pritet të hyjë në fuqi në vitin 2020, atëherë kur edhe përfundon afati i përcaktuar për vlefshmërinë e Protokolit të Kyotos.

Edhe pse kontributi i Kosovës në emetimin e gazrave të serrës në nivel global pothuajse është i papërfillshëm, angazhimi i saj për t'iu bashkuar përpjekjeve botërore për të reduktuar emetimet e gazrave të serrës kanë qenë evident. Padyshim që një nga aktivitetet me të rëndësishme në këtë drejtim është përgatitja e inventarit nacional të gazrave të serës, si një nga mekanizmat kryesorë për të identifikuar burimet kryesore të emetimeve me qëllim të zbatimit të masave për reduktimin e tyre.

Në këtë raport është prezantuar inventari i gazrave serrë për Kosovën për periudhën kohore 2008-2013, ku janë përfshirë burimet kryesore të gazrave të serrës sipas sektorëve dhe rekomandimet për reduktimin e këtyre emetimeve.

Përmbajtje

1. Hyrje
2. Metodologjia dhe procesi
3. Emetimet e përgjithshëm të gazrave serrë në Kosovë
4. Emetimet nga Sektori i Energjisë
5. Emetimet nga Sektori i Proceseve Industriale dhe Përdorimi i Produkteve
6. Emetimet nga Sektori i Bujqësisë
7. Emetimet nga Sektori i Pylltarisë dhe Përdorimi i Tokës
8. Emetimet nga Sektori i Mbeturinave
9. Rekomandimet për hapat e mëtejme
10. Referencat dhe Burimet

1. Hyrje

Kosova ende nuk është palë e Konventës Kornizë për Ndryshimin Klimatik (UNFCCC). Megjithkëtë Kosova është shtet në zhvillim dhe vend me perspektivë për anëtarësim në BE. Në procesin e integritetit në BE, krahas aspekteve tjera kërkohet edhe adaptimi dhe implementimi i legjislacionit përkatës. Sa i përket ndryshimeve klimatike politikat e BE-së janë në linjë me kërkesat e Konventës Kornizë për Ndryshimin Klimatik (UNFCCC), prandaj duke adaptuar dhe transpozuar legjislacionin e BE-së, Kosova në mënyrë indirekte plotëson edhe kërkesat që dalin nga kjo Konventë.

Deri me tani Kosova përmes MMPH-së, ka bërë një sërë veprimesh për të përmbushur nevojën për monitorimin e ndryshimeve klimatike, adaptimin ndaj tyre dhe zbutjen e ndikimeve që vijnë nga këto ndryshime.

Në kuadër të legjislacionit nacional për ndryshime klimatike, aspektet që ndërlidhen me këto ndryshime janë përfshirë në legjislacionin mjedisor përkatës duke përfshirë Ligjin e Mjedisit, Ligjin për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Ligjin e ujërave dhe ligjet tjera relevante.

Janë miratuar edhe aktet nënligjore përkatëse sikurse janë ato për substancat që e dëmtojnë shtresën e ozonit dhe gazrat serrë të fluoruara, dhe ato për informimin e konsumatorit për ekonominë e karburantit dhe emetimet e CO₂ të makinave të reja të pasagjerëve.

Janë në proces të miratimit edhe dy udhëzimeve administrative të rëndësishme sikurse janë: Udhëzimi Administrativ për monitorimin e emisioneve të gazrave serrë, dhe Udhëzimi administrative për mekanizmat për përcjelljen e emisioneve të gazrave serrë.

Është miratuar Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2014-2024, e cila është në përputhje me kornizën e pritshme të politikave të BE-së për klimën dhe energjinë. Kjo strategji është e bazuar në konceptin e zhvillimeve me emetim të ulët të karbonit dhe përshtatjes ndaj tyre. Në kuadër të objektivave kryesore të kësaj strategjie: Kosova do t'i zhvillojë kapacitetet për t'i përmbushur obligimet e saj të ardhshme në kuadër të Konventës UNFCCC dhe si anëtare e BE-së, si dhe do të ngadalësojë rritjen e emetimeve të Gazrave Serrë përmes: rritjes së eficiencës së energjisë në të gjithë sektorët, zhvillimit të burimeve të energjisë të ripërtërishme, dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Krahas strategjisë Kornizë për Ndryshime klimatike është punuar edhe në nivele më të ulëta sektoriale sikurse është Plani i Veprimit mbi Zhvillimin e Politikave të Reja dhe Promovimi i Iniciativave Lokale në Menaxhimin e Ndryshimeve Klimatike (2012-2018), si dhe Strategjinë për Ndryshime Klimatike në sektorin e Pylltarisë. Veprime që ndërlidhen me uljen e emisioneve të gazrave serrë, zbutjen e ndikimeve klimatike dhe adaptimin ndaj tyre janë përfshirë edhe në kuadër të strategjive dhe planeve tjera nacionale sikurse janë Plani i Veprimit për Mbeturina, Plani i Veprimit për Cilësinë e Ajrit etj.

Në kuadër të aktiviteteve në sektorin e ndryshimeve klimatike Kosova ka përgatitur edhe regjistrin (inventarin) e gazrave serrë për vitet 2008-2013.

2. Metodologjia dhe procesi

Përgatitja e inventarit të gazrave serrë për periudhën kohore 2008-2013 është realizuar në tri faza. Në fazën e parë me mbështetje të UNDP është realizuar projekti “Transferimi i eksperiencës çeke për ngritjen e sistemit për menaxhimin e inventarit të gazrave serrë”. Në kuadër të këtij projekti është përgatitur inventari për vitet 2008-2009.

Në fazën e dytë që është implementuar gjatë vitit 2013, UNDP ka mbështetur projektin “Transferimi i eksperiencës çeke për aktivizimin e sistemit për monitorimin e gazrave serrë”, i cili kishte si qëllim kryesor të përgatisë ekspertët nacional për aplikimin e metodologjive për përgatitjen e inventarit të gazrave serrë. Në kuadër të këtij projekti është përgatitur inventari për vitin 2012.

Ndërsa në fazën e tretë grupi i ekspertëve nga AMMK ka përgatitur inventarin për vitin 2013 dhe ka plotësuar atë edhe me vitet 2010 dhe 2011.

Gjatë kësaj faze ekspertët nacional kanë mbledhur të dhënat për inventarin dhe i kanë përgatitur ato sipas kërkesave të manualit të IPCC 2006. Po ashtu edhe zgjedhja e metodologjive dhe faktorëve të emisionit është bërë në harmoni me këtë udhëzues.

Ky raport prezanton të dhënat e inventarit për vitin 2013 dhe përmbledhjen e të dhënave kryesisht për periudhën kohore 2008-2013.

3. Emetimet e përgjithshme të gazrave serrë në Kosovë

Në kuadër të monitorimit të emisioneve të gazrave serrë, Kosova deri me tani ka përgatitur inventarin e gazrave të serrës për periudhën kohore 2008-2013. Vlerësohet që emetimet vjetore të gazrave serrë në Kosovë janë rreth 9.5 milion ton CO₂ equivalent. Burimi kryesor i gazrave serrë është sektori i energjisë me pjesëmarrje prej 88% të totalit të emetimeve. Sektori i dytë është bujqësia me 7%. Sektori i mbeturinave përfaqëson 3% të totalit të emisioneve kurse sektori i proceseve industriale dhe përdorimit të produkteve me rreth 2.5%. Sektori i pylltarisë dhe i shfrytëzimit të tokës është sektori i vetëm akumulues i gazrave serrë.

Tabela 1: Emisionet e gazrave të serrës në Kosovë sipas sektorëve për vitin 2013

Emisionet e GHG në Kosovë për vitin 2013	Gg CO ₂ eq.
Gjithsej emisione	9568.4
Energjia	8428.4
Proceset industriale	198
Shfrytëzimi i produkteve	36
Bujqësia	690
Pylltaria dhe shfrytëzimi i tokës	-34
Mbeturinat	250




Figura 1: Emetimi i GHG në % sipas sektorëve

Trendi i emisioneve totale të GHG në Kosovë në vitin 2013 shënon një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2012 (9568.4 Gg CO₂ eq në vitin 2013, krahasuar me 9526.7 Gg Co₂ eq në vitin 2012). Ndërsa që viti me emetimet më të mëdha nga inventari i deritanishëm vlerësohet të jetë viti 2009 me 10507.2 Gg CO₂ eq. Duhet ditur se sasia e emetimeve të gazrave serrë në Kosovë është e varur shumë nga sasia e energjisë së prodhuar nga thëngjilli që është burimi kryesor i gazrave të serrës në vendin tonë.




Figura 2: Totali i emisioneve të GHG në Kosovë 2008-2013

Krahasuar me shtetet tjera në Evropë, Kosova ka emetime relativisht të ulëta për kokë banori (5.7 ton CO₂ ekuivalent për kokë banori), derisa emetimet e gazrave serrë për njësi të BPV (Bruto Prodhimi Vendor) janë 0,84 kg CO₂ ekuivalent.




Figura 3: Emetimet e CO₂ (ton equivalent) për kokë banori në Kosovë krahasuar me disa vende të regjionit, Evropës, EU, botë

4. Emetimet nga sektori i energjisë

Sektori i Energjisë, përfshin rreth 88% të emetimit të përgjithshëm të gazeve serrë në Kosovë ose 8428.21 Gg (Giga gram) CO₂ ekuivalent (eq.). Emisionet e gazrave serrë për këtë sektorë janë kalkuluar sipas metodologjisë IPCC 2006, duke zbatuar faktorët e emisionit relevant sipas TIER 1.

Ky sektor i takon kategorisë së parë sipas IPCC 2006 dhe përbëhet nga tre nën-sektorë (kategori) tjerë. Nën sektori i parë 1.A përfshinë Emetimin nga aktivitetet me djegie të karburantit, 1.B. Emisionet që vijnë nga eksplorimi, shfrytëzimi, dhe shpërndarja e lëndëve djegëse si dhe nën-sektori 1.C. Ruajtja dhe transporti i Dioksidit të Karbonit.

Burimet kryesore të emetimit të CO₂ në sektorin e energjisë vijnë nga nën-sektori i parë 1.A. Aktivitetet nga djegia e karburanteve. Këtu bëjnë pjesë kryesisht emetimet nga prodhimi i energjisë elektrike, ngrohtorja, transporti dhe industritë prodhuese. Nga ky nën sektor vijnë 8392.4 CO₂ eq apo 99,95 % e total CO₂ eq, në sektorin e energjisë pasi që dy nën-sektoret tjerë 1.B. që vijnë nga eksplorimi, shfrytëzimi, dhe shpërndarja e lëndëve djegëse nuk është një burim i rëndësishëm i shkarkimeve të Gazrave Serrë në Kosovë 35.85 CO₂ eq apo 0,5 %, sepse vetëm minierat e braktisura (të vogla) dhe minierave të hapura sipërfaqësore (linjiti) ndodhen në Kosovë, dhe 1.C. Ruajtja dhe transporti i Dioksidit të Karbonit po ashtu nuk është relevante për Kosovën.

Tabela 2: Kategoritë e gazrave serrë në sektorin e energjisë sipas IPCC 2006

Kategoria sipas IPCC 2006
1- Energjia
1.A - Aktivitetet nga djegia e karburanteve
1.A.1 – Industritë e energjisë
1.A.2 – Industritë e prodhimit dhe ndërtimit
1.A.3 – Transporti
1.A.4 – Sektorët tjerë
1.A.5 – Te pa specifikuar
1.B – Emisionet nga karburantet fugitive
1.B.1 – Lende djegëse të ngurta
1.B.2- Nafta dhe gaz natyror
1.B.3 – Emisionet tjera nga prodhimi i energjisë
1.C – Ruajtja dhe transporti i CO₂
1.C.1 – Transporti i CO ₂
3.C.5 – Deponimin e CO ₂
3.C.6 – Tjera

Në vitin 2013, janë regjistruar rreth 6431 Gg CO₂ eq. nga industritë e energjisë që përbën rreth 76 % të emetimeve nga ky sektor, 965.95 Gg CO₂ eq., nga transporti apo 11.5% të totalit të emetimeve të CO₂ në sektorin e energjisë.

Tabela 3: Burimet kryesore të emetimeve të gazrave serrë në sektorin energjisë

Burimet e emisioneve	CO ₂ Gg. eq.	%
1.A.1 – Industritë e energjisë	6431.05	76.3
1.A.2 – Industritë e prodhimit dhe ndërtimit	549.33	6.5
1.A.3 – Transporti rrugor	965.94	11.5
1.A.4 – Sektorët tjerë nga djegia e karburanteve	446.02	5.3
1.B.1 – Lende djegëse të ngurta	35.85	0.4




Figura 4: Pjesëmarrja në % e emetimeve sipas kategorive të sektorit të energjisë

Sipas të dhënave nga viti 2008 deri në vitin 2013, vërehet një ngritje -ulje e emetimeve të CO₂ gjatë viteve. Edhe në vitin 2013 kemi një ngritje të CO₂ në krahasim me vitin paraprak.




Figura 5: Trendi i emisioneve të GHG për sektorin e Energjisë 2008-2013

Burimi kryesor i këtyre të dhënave për këtë sektorë janë Balancat e energjisë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Mundësitë kryesore për reduktimin e emisioneve nga ky sektor do të ishin rritja e përdorimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë: energjia diellore, energjia e erës, ujit si dhe reduktimi i përdorimit të thëngjillit për energji, kurse në sektorin e transportit zëvendësimi i veturave të vjetra me të reja, përdorimi i transportit publik dhe promovimi i transportit të qëndrueshëm me më pak trafik motorik, çiklizëm etj.

5. Emetimet nga sektori i proceseve industriale dhe shfrytëzimi i produkteve

Sektori i Proceseve Industriale dhe Përdorimi i Produkteve i takon sektorit të dytë sipas IPCC 2006 dhe është sektori më kompleks. Ndahet në dy kategori që përmbajnë disa nënsektore (nënkategori) të cilët janë: Proceset Industriale - **IP** (2A, 2B dhe 2C) dhe Përdorimi i Produkteve - **PU** (2D, 2E, 2F dhe 2G).

Proceset Industriale- Emetimet nga sektori i Proceseve Industriale përfshijnë emisionet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të gazrave sere të cilët janë si produkte të proceseve industriale që kimikisht ose fizikisht transformojnë materiale të ndryshme, për shembull furnalatat në industrinë e hekurit dhe çelikut, amoniaku dhe produkte të tjera kimike të prodhuara nga lëndët djegëse fosile që përdoren si lende të pare kimike dhe industria e çimentos janë shembuj tërësorë të proceseve industriale që emetojnë një sasi të konsiderueshme të CO₂.

Sektori i Proceseve Industriale përbëhet nga 3 grupe logjike të kategorive:

1. Industria minerale (2A);
2. Industria kimike (2B);
3. Industria e Metaleve (2C);

Sektori i Proceseve Industriale, përfshin rreth 2% të emetimit të përgjithshëm të gazeve serrë në Kosovë gjatë vitit 2014 ose rreth 215.72 Gg (Giga gram) CO₂ ekuivalent (eq.), përkatësisht 215.72 mijë ton CO₂ ekuivalent. Emisionet e gazrave serrë për këtë sektorë janë kalkuluar sipas metodologjisë IPCC 2006, duke zbatuar faktorët e emisionit relevant sipas TIER 1.

Tab.4. Burimet kryesore të emetimeve të gazrave sere në sektorin e procesve industriale sipas nën- sektorëve

Burimet e emetimeve	(Gg)	
	CO ₂	%
2 - Proceset Industriale	215.71	
2.A.1 – Prodhimi i çimentos	192.94	89.4
2.A.2 – Prodhimi i gëlqeres	7.46	3.5
2.A.4.d – Tjera (Prodhimi i Fe-Ni)	15.29	7.1

Nga analiza e rezultateve për emisionet e CO₂ nga sektori i Proceseve Industriale për vitin 2014 vërehet se pjesëmarrje me të lartë me emetim të CO₂ është nga prodhimi i çimentos me 89%, pastaj nga prodhimi i FeNi me 7.1% dhe nga prodhimi i gëlqeres me 3.5 %.




Figura 6: Pjesëmarrja ne % e emetimeve sipas kategorive të sektorit të proceseve industriale

Nëse e analizojmë trendin e emetimit të CO₂ nga procesi industrial për prodhimin e çimentos për periudhën 2006-2014, vërejmë se në vitin 2014 ka një ngritja të lehtë të emisioneve në krahasim me vitin paraprak. Në vitin 2014 janë regjistruar në total 192.94 Gg CO₂ eq. nga procesi i prodhimit të çimentos ndërsa që në vitin 2013 ishin 179.59 Gg CO₂ eq.. Viti 2012 është viti ku janë regjistruar emisionet më të ulëta në këtë sektor (83.98 Gg CO₂ eq.) për periudhën 2007-2014, ndërsa viti 2008 ishte viti ku janë regjistruar emisionet me të larta në këtë sektor (204.79 Gg CO₂ eq.).




Figura 7. Sasia e emetimit të CO₂ (Gg/vite) nga procesi i prodhimit të çimentos 2006-2014

Nga analiza e rezultateve të kalkulimit të emisioneve të CO₂ nga procesi industrial për përpunimin e xehes se Fe-Ni për periudhën 2008-2014, vërejmë se në vitin 2014 ka ngritja të emisioneve të CO₂ në krahasim me vitin paraprak. Në vitin 2014 janë regjistruar në total 15.29 Gg CO₂ eq (15290 ton CO₂) nga procesi i përpunimit të xehes se Fe-Ni ndërsa që në vitin 2013 ishin 10.71 Gg CO₂ eq. Viti 2012 është viti ku janë regjistruar emisionet më të ulëta në këtë sektor (8.48 Gg CO₂ eq.) gjatë periudhës 2008-2014, ndërsa viti 2011 dhe 2014 janë vitet ku janë regjistruar emisionet me të larta të CO₂ në këtë sektor (204.79 Gg CO₂ eq.).




Figura 8. Sasia e emetimit te CO₂ (Gg/vit) nga procesi industrial për përpunimin e xehes së FeNi

Rezultatet e kalkulimeve të emisioneve të CO₂ nga procesi i përpunimit të gëlqeres për periudhën 2011-2014, tregojnë se në vitin 2014 ka një ulje të emisioneve te CO₂ në krahasim me vitin paraprak. Në vitin 2014 janë regjistruar në total 7.46 Gg CO₂ eq (7460 ton CO₂) nga procesi i përpunimit te gëlqeres ndërsa në vitin 2013 ishin 7.502 Gg CO₂ eq. Viti, ndërsa viti 2013 ishte vite ku janë regjistruar emisionet me te larta te CO₂ ne këtë sektor (7.502 Gg CO₂ eq).




Figura 9. Sasia e emetimit të CO₂ (Gg/vit) nga procesi i prodhimit te gëlqeres

Emisionet totale të CO₂ (Gg/vite) nga Industria Minerale (2A) dhe nga Industria e Metaleve (2C) per periudhën 2006-2014 janë paraqite ne figurën 9 . Nga kjo fig. 10 vërehet se vlera maksimale e emisionit te CO₂ është paraqite ne vitin 2014 (215.68 Gg CO₂ eq), ndërsa vlera me e ulet është paraqite ne vitin 2012 (99.93 Gg CO₂ eq.).




Figura 10. Emisionet totale të CO2 nga 2A dhe 2C për periudhën 2006-2014

Duhet të përmendet se sasia e emisioneve të CO2 nga periudha 2006-2008 i përgjigjet emisioneve të CO2 vetëm nga proceset industriale të prodhimit të çimentos, periudha 2008-2011 i përgjigjet emisioneve nga aktiviteti i përpunimit të çimentos dhe nga aktiviteti i përpunimit të xehes se FeNi, ndërsa periudha 2011-2014 përfshin emisionet nga aktiviteti i përpunimit të xehes se FeNi, prodhimit të çimentos dhe prodhimit të gëlqeres (shih fig.11).




Figura 11. Trendi i emisioneve totale të CO2 nga sektori i proceseve industriale 2006-2014

Per kalkulimin e emisioneve të CO2 janë përdore të dhënat mbi sasinë e prodhimit vjetore të klinkerit, sasia vjetore e prodhimit të gëlqeres dhe sasia vjetore e përpunimit të xehes se FeNi. Këto të dhëna janë marre drejtpërdrejte nga operatorët ekonomike (Sharr Cem, New Co- FeNi dhe Fabrika e prodhimit të Gëlqeres në Kaçanik).

Sasia e emisioneve të CO2 varet nga sasia e prodhimit të çimentos që zhvillojnë operatorët ekonomike do të thotë se me zhvillimin e ekonomive industriale rritet edhe sasia e emisioneve të CO2 në ajër.

Mundësia e zvogëlimit të emisioneve të CO2 është përdorimi i teknologjisë për zënien e CO2 ose zvogëlimi i prodhimit të çimentos.

Përdorimi i Produkteve- ky sektor përfshin emisionet nga përdorimi i oksideve nitroze (N₂O) – anestetikët, përdorimi i komponimeve organike volatile jo-metanike dhe nga përdorimi i solventëve si dhe përmbajtja e produkteve solvente. Shumë gazra serë të ndryshëm duke përfshirë doksidin e karbonit CO₂, Oksidin e dyazotit (N₂O), Hidrofluorokarbonet (HFCs) dhe perfluorokarbonet(PFCs), duke përfshire këto kategori:

- ✓ Produktet jo-energjiqe nga vajrat dhe përdorimi i tretësve (solventëve),
- ✓ Industria elektronike,
- ✓ Përdorimi i Produkteve si zëvendësim i substancave Ozon holluese,
- ✓ Manufakturimi dhe përdorimi i produkteve të tjera.

Burimet emetuese ne sektorin per Përdorimin e Produkteve janë paraqite ne tabelën 5, nga ku është dhëne sasia e substancave emetuese per vitin 2013. Nga këto burime emetuese , emetohet CO₂ , N₂O dhe HFCs.

Tabela 5. Burimet e emetimeve të gazrave serrë në sektorin e përdorimit të produkteve

Burimet e emetimeve	(Gg) CO ₂ equivalent			
	CO ₂	CH ₄	N ₂ O	HFCs
2 – Përdorimi i produkteve	1.48	0	4.34	30
2.D – Produktet jo energjetike nga lëndët djegëse dhe përdorimi i tretësve (6)	1.48	0	0	0
2.D.1 – Përdorimi i lubrifikantëve	1.0			
2.D.2 – Përdorimi i parafinës	0.09			
2.D.4 – Përdorimi i produkteve tjera (3), (8)	0.38			
2.F – Përdorimet e produkteve të cilat përdoren si zëvendësim për Substancat që Zvogëlojnë Ozonin	0	0	0	29.92
2.F.1 – Ftohësit dhe kondicionuesit e ajrit	0	0	0	29.9
2.F.1.a – Ftohësit dhe kondicionuesit statik (stacionet)				24.5
2.F.1.b – Kondicionuesit mobil të ajrit				5.4
2.G - Manufakturimi dhe përdorimi i produkteve të tjera	0	0	0.014	0
2.G.3 - N ₂ O nga përdorimi i produkteve	0	0	0.014	0
2.G.3.a – Përdorimi i produkteve në mjekësi			0.014	
Totali i emetimeve nga sektori i përdorimit të produkteve	36 Gg CO₂ equivalent			

Pjesëmarrja ne % e CO₂, N₂O dhe HFCs (GgCO₂ Eq) në emisionet totale nga sektori i Përdorimit të produkteve është dhëne ne figurën 12.




Figura 12. Pjesëmarrja në % e garzrave të serrës në sektorin e përdorimit të produkteve për vitin 2013

Nga fig.12 shihet pjesëmarrja me e madhe e sasisë se gazrave sere te emetuar nga sektori i përdorimit të produkteve janë emisionet e HFCs me 29.97 ose 83.36 % nga vlera totale e emisioneve, ndërsa vlerat e N2O është 4.5 Gg CO2 Eq ose 12.5%, kurse vlera e emisioneve te CO2 arrin ne 1.48 ose 4.1% pjesëmarrje nga totali i emisioneve të sektorit te PU per vitin 2013. Ne vazhdim janë dhëne grafikonet ku janë paraqite trendi i emisioneve te gazrave të CO2, N2O dhe HFCs nga burimet e ndryshme, per periudhën 2008-2013.

Emisionet e CO2 nga përdorimi i lubrifikanteve ne vitin 2013 ka shënuar ngritje ne krahasim me vitin 2011 dhe 2012, ndërsa vlera me e larte për periudhën 2008-2013 është regjistruar në vitin 2008. Nëse shikojmë figurën 13 vërehet se në vitin 2012 është regjistruar vlera më e ulët e emisioneve të CO2 për këtë periudhë kohore.




Figura 13. Trendi i emisioneve totale të CO2 nga përdorimi i lubrifikuesve 2008-2013

CO₂ i emituar nga përdorimi i Parafin Wax është i ndryshueshëm nga viti në vit nuk është paraqite ndonjë trend stabil ne ngritje apo rënie, por në vitin 2013 emisioni i CO₂ nga përdorimi i Parafin Wax ka shënuar një rënie të lehtë në krahasim me vitin paraprak (2012). Vlera maksimale e emisionit te CO₂ është paraqite ne vitin 2011.




Figura 14. Trendi i emisioneve totale të CO₂ nga përdorimi i parafinës 2008-2013

Emisionet e CO₂ nga përdorimi i solventëve (tretësve) ne vitin 2013 shënuan një ngritje ku vlera e emisionit te CO₂ arrin ne 0.388 Gg ne krahasim me vitin 2012 sa ishte 0, 277 Gg, por nëse shohim vlerën e emisioneve për periudhën 2008-2013, vërejmë se nuk ka ndonjë ngritje te larte, mundë te themi se kemi një trend stabil.




Figura 15. Trendi i emisioneve totale të CO₂ nga përdorimi i solventëve (tretësve) 2008-2013

Emisionet e N₂O vijnë si rezultat i përdorimit të tij në mjekësi si anestezi. Po të analizojmë figurën e paraqitur ne vazhdim vërejmë se vlera e emisioneve të N₂O është në ngritje por kjo vlerë është e ulët sa që në emisionet totale është pothuajse e papërfillshme.




Figura 16. Trendi i emisioneve totale të CO₂ nga përdorimi i parafinës 2008-2013

Burimi kryesor i të dhënave për këtë sektorë janë Doganat e Kosovës. Mundësitë e reduktimit të emisioneve nga ky sektorë janë kontrolli i përdorimit të produktve që hollojnë shtesën e ozonit. Këto substanca janë kryesisht pjesë e përdorimit shtëpiak të frigoriferëve, ftohësve me presion të lartë dhe sistemet e lëvizshme apo stabile të kondicionimit të ajrit. Aktualisht ky sektor nuk ka ndonjë ndikim me rëndësi në totalin e emisioneve nacionale, mirëpo varësisht nga trendi i zhvillimit të vendit pritet të rriten edhe emetimet nga ky sektor.

6. Emetimet nga sektori i bujqësisë

Sektori i Bujqësisë, përfshin rreth 7% të emetimit të përgjithshëm të gazeve serrë në Kosovë ose rreth 700 Gg (Giga gram) CO₂ ekuivalent (eq.), përkatësisht 700 mijë ton CO₂ equivalent. Emisionet e gazrave serrë për këtë sektorë janë kalkuluar sipas metodologjisë IPCC 2006, duke zbatuar faktorët e emisionit relevant sipas TIER 1.

Ky sektor i takon kategorisë së tretë sipas IPCC 2006 përbëhet nga dy nën sektorë (kategori) tjera. Nën sektori i parë 3A përfshinë emetimin nga bagëtia. Këtu bëjnë pjesë kryesisht emetimet e metanit nga fermentimi enterik (procesi digjektiv i kafshëve) dhe emetimet e oksidit të azotit dhe metanit nga menaxhimi i plehrave të kafshëve. Nga ky nën sektor vijnë rreth 550 Gg CO₂ eq. në vit.

Nën sektori i dytë 3C trajton emetimet nga fertilizimi i tokës dhe nga djegia e biomasës. Kategoritë më të rëndësishme të këtij nën sektori janë emetimet indirekte të oksidit të azotit që lidhen me menaxhimin e plehrave dhe fertilizimin e drithërave. Gjithsej, ky nën sektor emeton rreth rreth 150 Gg CO₂ eq në vit.

Tabela 7: Kategoritë dhe nënkategoritë e gazrave serrë në sektorin e bujqësisë sipas IPCC 2006

Kategoria sipas IPCC 2006	Gazrat		
	CO ₂	CH ₄	N ₂ O
3.A – Bagëtia			
3.A.1 – Fermentimi Enterik		✓	
3.A.2 – Menaxhimi i plehut		✓	✓
3.C – Burimet e agreguara dhe burimet e emetimit të jo-CO₂ në tokë			
3.C.1 – Emisionet nga djegia e biomasës		✓	✓
3.C.3 – Aplikimi i UREA-s	✓		
3.C.4 – Emisionet direkte të N ₂ O nga menaxhimi i tokave/dheut			✓
3.C.5 – Emisionet indirekte të N ₂ O nga menaxhimi i tokave/dheut			✓
3.C.6 – Emisionet indirekte të N ₂ O nga menaxhimi i plehut			✓

Në vitin 2013, janë regjistruar rreth 690 Gg CO₂ eq.. Fermentimi enterik (procesi digjektiv i kafshëve), përbën 70 % të emetimeve ose 470 Gg CO₂ eq., i pasur nga emisionet direkt të N₂O nga menaxhimi i tokës (dheut) me 11% (77 Gg eq.), dhe nga emetimet nga menaxhimi i plehut të kafshëve me 9% (57 Gg eq.).

Metanit (CH₄) me pjesëmarrje prej 77% të totalit, është gazi kryesor i emetuar i këtij sektori i pasur nga Oksidi i Azotit (N₂O) me 20% dhe Dyoksidi i Karbonit (CO₂) me 3%.

Tabela 7: Burimet kryesore të emetimeve të gazrave serrë në sektorin e bujqësisë sipas nën sektorëve

Burimet e emisioneve	CO ₂ Gg eq.	%
Fermentimi Enterik (procesi digjestiv i kafshëve)	470	70
Emisionet direkte të N ₂ O nga menaxhimi i tokës (dheut)	77	11
Emisionet indirekte të N ₂ O nga menaxhimi i tokës (dheut)	37	6
Menaxhimi i plehut të kafshëve	57	9
Emisionet indirekte të N ₂ O nga menaxhimi i plehut të kafshëve	9	1
Aplikimi i UREA-s	20	3
Djegia e biomasës	2	0




Figura 17: Burimet kryesore të emetimeve në sektorin e bujqësisë %




Figura 18: Gazrat serrë sipas pjesëmarrjes (%) në sektorin e bujqësisë

Nëse e analizojmë trendin e emetimeve për periudhën 2007-2013, vërejmë se në vitin 2013 ka një rënie të ndjeshme të emisioneve në krahasim me vitin paraprak. Në vitin 2013 janë regjistruar në total 690 Gg CO₂ eq. në sektorin e bujqësisë ndërsa që në vitin 2012 ishin 732 Gg CO₂ eq.. Viti 2011 është viti ku janë regjistruar emisionet më të larta në këtë sektor (740 Gg CO₂ eq.) për periudhën 2007-2013.




Figura 19 : Trendi i emisioneve të CO₂ nga sektori i bujqësisë 2007-2013

Burimet kryesore të informatave (të dhënave aktive) për kalkulimin e emisioneve nga ky sektor përbëjnë të dhënat për numrin e bagëtive sipas kategorisë, të dhënat për format e menaxhimit të plehut të stallës, të dhënat për sasisë vjetore të UREA-s dhe fertilizerëve të përdorura për fertilizim (plehërim), të dhënat për prodhimin bujqësor, të dhënat për sipërfaqet e djegura sipas kategorive të tokave si dhe disa të dhëna për klimën dhe temperaturën mesatare vjetore. Burimi kryesor i këtyre të dhënave është Anketa e Ekonomive Bujqësore nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Problemi kryesor sa i përket të dhënave të nevojshme për përmirësimin e inventarit për këtë sektor është mungesa e të dhënave specifike për secilën nga kategoritë e të dhënave të përmendura më lart, mungesa e të dhënave historike (1990 e kënde) si dhe mungesa e përvojës në këtë sektor. Bashkëpunimi ndër-institucionale, angazhimi i ekspertëve të sektorit dhe realizimi i trajnimeve specifike do të ishin të nevojshme për të përmirësuar inventarin e të dhënave të gazrave serrë nga ky sektor.

Mundësitë kryesore për reduktimin e emisioneve nga ky sektor do të ishin zvogëlimi i sipërfaqeve të djegura sipas kategorive të tokave, menaxhimi më efikas i plehut të shtallës dhe përdorimi i kontrolluar i fertilizerëve.

7. Emetimet nga sektori i pylltarisë dhe përdorimi i tokës

Kjo kategori përfaqëson sektorin e vetëm të akumulimit të gazrave të serrës në kuadër të regjistrit total të emisioneve në Kosovë. Sipas IPCC 2006 ky sektor bënë pjesë në kategorinë 3B.

Emisionet e gazrave serrë për këtë sektorë janë kalkuluar sipas metodologjisë IPCC 2006, duke zbatuar faktorët e emisionit relevant, duke llogaritur ndërrimet në stoqet e karbonit sipas kategorive të shfrytëzimit të tokave, dhe përmes zbatimit të matricës së konvertimit të tokave sipas kategorive.

Burimet e emisioneve të gazrave serrë në kuadër të kësaj kategorie përfshijnë:

- ✓ 3.B.1 Tokat Pyjore
- ✓ 3.B.2 Tokat Bujqësore
- ✓ 3.B.3 Kullotat
- ✓ 3.B.4 Tokat e lagura
- ✓ 3.B.5 Vendbanimet
- ✓ 3.B.6 Toka tjera

Sektori përfshinë ndërrimet në stokun e karbonit, emisionet e gazrave serrë (CO₂, CH₄, & N₂O), sipas burimeve, akumulimin e CO₂ nga format e shfrytëzimit të tokave, ndërrimet në shfrytëzimin e tokave dhe aktivitetet në sektorin e pyjeve.

Në vitin 2013 në kuadër të këtij inventari janë regjistruar akumulime (thithje) të karbonit prej rreth -34 Gg CO₂ equivalent, përfshirë këtu akumulimin prej -40 Gg CO₂ equivalent nga nënsektori i tokave pyjore dhe emetimin e 6 Gg CO₂ equivalent nga nënsektori i ndërrimeve në shfrytëzimin e sektorit të kullosave.

Nëse e analizojmë trendin e emetimeve (akumulimeve) nga ky sektor gjatë periudhës viteve 2008-2013, vërejmë se në vitin 2013 (-34 Gg CO₂ equivalent) ka pasur një rritje të ndjeshme emisioneve në krahasim me vitin paraprak (-39 Gg CO₂ equivalent), ndërkohë që viti 2009, është viti me emisionet më të larta të regjistruara (-30 Gg CO₂ equivalent).




Figura 20: Trendi i emisioneve të CO₂ në sektorin e pyjeve dhe shfrytëzimit të tokave 2008-2013

Të dhënat kryesore për kalkulimin e emisioneve për këtë sektor janë marrë nga Inventari i pyjeve të Kosovës 2003 dhe 2013. Kategoritë e shfrytëzimit të tokave nga ky inventar janë përshtatur me kategoritë relevante të shfrytëzimit të tokave sipas IPCC 2006.

Ky sektor konsiderohet së një ndër sektorët më sfidues në inventarit kombëtar të emetimit, në aspektin e metodologjive, kërkesave të të dhënave, burimit dhe pasigurive që lidhen me vlerësimet gjeneruara emisionit.

Problemi kryesor sa i përket të dhënave të nevojshme për përmirësimin e inventarit për këtë sektor është mungesa e të dhënave vjetore specifike për secilën nga kategoritë e të dhënave të përmendura më lart, mungesa e të dhënave historike (1990 e kënde) si dhe mungesa e përvojës në këtë sektor. Bashkëpunimi ndërinstitucionale, angazhimi i ekspertëve të sektorit dhe realizimi i trajnimeve specifike do të ishin të nevojshme për të përmirësuar inventarin e të dhënave të gazrave serrë nga ky sektor.

Po ashtu për të përmirësuar të dhënat dhe inventarin për këtë sektor mundë të shfrytëzohen edhe të dhënat nga ndryshimet dhe revidimet e bëra në kuadër të të dhënave për Corine Land Cover (CLC 2006-2012).

Mundësitë kryesore për reduktimin e emisioneve nga ky sektor do të ishin zvogëlimi i prerjeve ilegale të pyjeve dhe ruajtja e destinimit të shfrytëzimit të tokave sipas kategorive.

8. Emetimet nga sektori i mbeturinave

Sektori i mbeturinave në Kosovë përfshin rreth 3% të emetimeve të përgjithshme nacionale të gazeve serrë. Sektori i mbeturinave i takon kategorisë së 4 sipas IPCC 2006 dhe përbëhet nga tri nënkategori (nën sektor) relevante për Kosovën. Nën sektori më i rëndësishëm është emetimi nga deponitë. Në kuadër të kësaj nënkategorie bëjnë pjesë emisionet nga deponitë e menaxhuara, deponitë e pa menaxhuara dhe deponitë të pa kategorizuara. Ky nënsektor prodhon rreth 200 mijë tonë CO₂ eq. në vit.

Nën sektori djegia e mbeturinave përfshinë emisionet nga incinerimin (djegia e mbyllur e mbeturinave në impiante) dhe djegia e hapur e mbeturinave. Në kuadër të këtij nën sektori ka disa instalime që djegin mbeturina të caktuara (mbeturinat klinike) por nuk ekziston impiant komunal për djegien e mbeturinave. Vlerësohet se një pjesë e mbeturinave digjet nëpër shtëpi, mirëpo kjo djegie nuk është vlerësuar në regjistër në mungesë të të dhënave.

Nënkategoria shkarkimi dhe trajtimi i ujërave të zeza përfshinë impiantet industriale të trajtimit të ujërave të zeza dhe trajtimi dhe shkarkimi i ujërave të zeza. Aktualisht nuk ka të dhëna për shkarkimet industriale të ujit apo të dhëna në lidhje me prodhimin industrial (për të vlerësuar ndotjen industriale). Prandaj, vlerësimi është bërë vetëm nga emisionet e trajtimit dhe shkarkimit të ujërave të zeza. Trajtimi i ujërave të zeza përfshin emetimin e metanit nga ujërat e zeza dhe llumi i gjeneruar r nga popullata. Vlerësohet se popullata në Kosovë prodhon pothuajse 90 mijë tonë CO₂ eq. nga kanalizimi (kryesisht i patrajtuar).

Tabela 9: Kategoritë dhe nënkategoritë e gazrave serrë në sektorin e bujqësisë sipas IPCC 2006

Burimet e emetimeve të GHG nga Mbeturinat	Emetimet (Gg)		
	CO ₂	CH ₄	N ₂ O
Totali i Emetimeve nga Mbeturinat	1.6	10.2	0.11
4.A – Deponimi i Mbeturinave të ngurta		7.5	
4.A.1 – Deponi të menaxhuara			
4.A.2 – Deponi të pa menaxhuara			
4.A.3- Deponi të pa kategorizuara			
4.C- Incenerimi dhe Djegia e Hapur e Mbeturinave	1.6	0.02	
4.C.1 – Incenerimi i Mbeturinave			
3.C.2 – Djegia e Hapur e Mbeturinave	1.6		
4.D. – Trajtimi dhe Shkarkimi i Ujërave të Zeza	0	2.7	0.11
4.D.1- Trajtimi dhe Shkarkimi i Ujërave të Zeza		2.7	0.11
4.D.2– Impiantet Industriale të Trajtimit dhe Shkarkimit të Ujërave			
Totali i emetimeve nga sektori i mbeturinave	250 Gg CO₂ eq.		

Në kuadër të emetimeve të gazrave serë nga sektori i mbeturinave gjatë vitit 2013 janë emetuar rreth 250 Gg CO₂ equivalent (1.6 Gg CO₂, 19.2 Gg CH₄ dhe 0.11 Gg N₂O), nga të cilat 157 Gg CO₂ equivalent nga kategoria e deponimit të mbeturinave, 85 Gg CO₂ equivalent nga trajtimi dhe shkarkimi i ujërave të zeza.

Analizuar sipas gazrave të serrës, në këtë sektor dominonë Metani me 85% të emisioneve, i pasur nga N₂O me 14% dhe CO₂ me vetëm 1%.




Figura 21: Gazrat serrë sipas pjesëmarrjes (%) në sektorin e mbeturinave

Nëse e analizojmë trendin e emisioneve nga sektori i mbeturinave për periudhën 2008-2013, do të vërejmë se në vitin 2013 ka një ngritje të ndjeshme të emisioneve në krahasim me vitin paraprak, ndërkohë që emetimet më të larta janë regjistruar në vitin 2009.




Figura 22: Trendi i emisioneve të CO₂ në sektorin e mbeturinave 2008-2013

Për kalkulimin e emetimeve të gazrave serë nga sektori i mbeturinave janë përdorur burime të ndryshme të informatave. Shumica e të dhënave janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, por ka raste që në mungesë të të dhënave është bërë një vlerësim i ekspertëve dhe nga ai vlerësim janë marrë si të dhëna valide. Për shkak të mungesës së të dhënave nga viti 1960 deri më tani, për sasinë e mbeturinave të deponuara, ne kemi përdorur disa të dhëna të vlerësuara. Këto të dhëna janë llogaritur duke përdorur supozimet se prodhimi i mbeturinave ka ndryshuar bashkë me GDP-në dhe përderisa Kosova nuk ka të dhëna afatgjata për GDP-në, atëherë janë përdorur të dhënat relevante për Shqipërinë. Si burim i të dhënave të GDP-së është Banka Botërore. Të dhënat për numrin e popullsisë janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Deponitë në Kosovë nuk i plotësojnë kushtet strikte anaerobe të nevojshme për formimin e metanit. Nëse deponitë do të plotësonin të gjitha praktikatat sanitare dhe të menaxhimit të mirëfilltë, atëherë potenciali i gjeneratës së metanit do të rritej në nivelin kur është ekonomikisht i përshtatshëm për ta tërhequr dhe për ta shfrytëzuar si lëndë djegëse.

Mundësi për të zvogëluar emisionet nga ky sektor është edhe menaxhimi më i mirë i mbeturinave përmes riciklimit dhe trajtimit. Me shtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza, përveç që do të përmirësohej cilësia e ujërave sipërfaqësore do të zvogëloheshin edhe emetimet e gazrave serrë nga kjo kategori.

9. Rekomandimet për hapat e mëtejme

Për të reduktuar gazrat serë në Kosovë rekomandohen të zbatohen këto masa:

- ✓ Rritja e përdorimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë,
- ✓ Reduktimi i përdorimit të thëngjillit për energji,
- ✓ Zëvendësimi i veturave të vjetra me të reja,
- ✓ Përdorimi i transportit publik dhe promovimi i transportit të qëndrueshëm me më pak trafik motorik,
- ✓ Përdorimi i teknologjisë për zënien e CO₂ në proceset industrial prodhuese,
- ✓ Kontrolli i përdorimit të produkteve që hollojnë shtesën e ozonit.
- ✓ Zvogëlimi i sipërfaqeve të djegura sipas kategorive të tokave,
- ✓ Menaxhimi më efikas i plehut të kafshëve,
- ✓ Përdorimi i kontrolluar i fertilizerëve.
- ✓ Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave përmes riciklimit, ndarjes dhe trajtimit të tyre,
- ✓ Përmirësimi i menaxhimit të ujërave të zeza përmes trajtimit,
- ✓ Zvogëlimi i prerjeve ilegale të pyjeve dhe ruajtja e destinimit të shfrytëzimit të tokave sipas kategorive.

Ndërsa për të përmirësuar monitorimin e gazrave serrë dhe sistemin e informimit për GHG rekomandohet të zbatohen këto masa:

- ✓ Kompletimi i infrastrukturës ligjore për monitorimin e gazrave serrë dhe për sistemin e informimit për gazrat serrë,
- ✓ Përcaktimi i vitit referent për Inventarin e Gazrave serë për Kosovën,
- ✓ Sigurimi i të dhënave historike për sektorët relevant të GHG,
- ✓ Përmirësimi i cilësisë së të dhënave sipas sektorëve,
- ✓ Ngrija e nivelit të bashkëpunimi ndërinstytucionale,
- ✓ Angazhimi i ekspertëve për sektorët relevant të gazrave serrë,
- ✓ Realizimi i trajnimeve specifike për secilin sektor,
- ✓ Përmirësimi i sigurimit të kontrollit të cilësisë.

10. Referencat dhe Burimet

- ✚ Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore 2013, *ASK 2014*
- ✚ Anketa e mbeturinave komunale 2013, *ASK 2014*
- ✚ Balanca e Energjisë 2013, *MZHE 2014*
- ✚ Disa fakte për mjedisin , *ASK 2015*
- ✚ Emetimi i gazrave serre në Kosovë 2008-2009, *UNDP 2012*
- ✚ Inventari i Pyjeve të Kosovës 2012, *APK 2013*
- ✚ Raporti për gjendjen e ajrit, *AMMK 2012*
- ✚ Raporti, gjendja e mbeturinave dhe kemikateve në Kosovë, *AMMK 2014*
- ✚ Raporti, Inventari i Gazrave Serre ne Kosovë për vitin 2012, *AMMK 2014*
- ✚ Regjistrimi i Bujqësisë 2014, *ASK 2015*
- ✚ Regjistrimi i popullsisë 2011, *ASK 2013*
- ✚ Strategjia dhe Plani i Veprimit për Cilësinë e ajrit 2011-2021, *MMPH 2012*
- ✚ Strategjia e Mbrojtjes së Klimës në Sektorin e Pylltarisë, *MBPZHR 2013*
- ✚ Strategjia për Ndryshime Klimatike 2014-2024, *MMPH 2015*
- ✚ Të dhënat nga Operatoret ekonomik (KEK, SharCem dhe NewCoFeronikel)

Raporti
“Emetimi i gazrave serrë në Kosovë 2008-2013”
është përgatitur nga Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

Ekipi kombëtar i inventarit të gazrave serrë:

Rizah Hajdari dhe Vlora Spanca- Sektori i Energjisë,
Letafete Latifi- Sektori i Proceseve Industriale,
Mentor Shala- Sektori i Përdorimit të Produkteve,
Afrim Berisha- Sektori i Bujqësisë,
Bajram Kafexholli- Sektori i Pylltarisë dhe Përdorimit të Tokave,
Mimoza Hyseni- Sektori i Mbeturinave

Adresa e AMMK-së:

Rruga Luan Haradinaj, ish-pallati i shtypit-Rilindja kati XV/04
Tel. +381 38 200 33 228 , email: kepa@rks-gov.net

www.ammk-rks.net